

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Turizmi në gusht shënon rritjen më të dobët që nga pandemia
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/turizmi-ne-gusht-shenon-rritjen-me-te-dobet-qe-nga-pandemia-i105989
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:51:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 09:42:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	77f24588a3b7315eb6601551679503101a411537a065c2a45bcb6cba1aea680c
TEKSTI	00f68c5f10827cd2046091015c966a856692f20116ed0ff6b3037a034dee97ab
PAMJA	2ca708a2cfa361174f3cd429725cfba1defc187bed452e4dac76fda7690f52bc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b9d99d1b88e6c92697892903fd8e4832d90e33ab01754cc0aede3ca64af04bc6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b9d99d1b88e6c92697892903fd8e4832d90e33ab01754cc0aede3ca64af04bc6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **shpenzimet** **mujore. A** **meritojnë** **ritjen më** **të dobët** **lë në burg** **Hasan** **dhe** **finandeze** **zbulonë** **e Postës** **Durrës i** **Korri** **dy të** **arrestu**

[AKTUALITET](#)

Turizmi në gusht shënon rritjen më të dobët që nga pandemia

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 11:42



Turizmi humbi ritëm në gusht. Hyrjet e shtetasve të huaj u rritën me vetëm 2% krahasuar me një vit më parë, ritmi më i ulët i rritjes për këtë muaj që nga pandemia.

Në gusht 2026 u regjistruan rreth 2.43 milionë hyrje të shtetasve të huaj, nga 2.38 milionë në të njëjtin muaj të vitit të kaluar. Gushti është zakonisht muaji që sjell numrin më të lartë të vizitorëve të huaj në vend dhe, ndonëse në terma absolute ky vit mbetet rekord, ritmi i rritjes është ngadalësuar ndjeshëm.

Pas rimëkëmbjes së fortë nga pandemia, hyrjet e të huajve në gusht u rritën me 11.2% në 2022, me 18.3% në 2023, me 7.2% në 2024 dhe me 9.9% në 2025. Rritja prej vetëm 2% këtë vit është më e dobëta e periudhës 2021-2026.

Ngadalësimi i gushtit bie më shumë në sy pas një korriku më të fortë, kur hyrjet e të huajve u rritën me 7.1% në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në tërësi, ecuria gjatë vitit ka qenë e luhatshme. Janari shënoi rënie prej 1.5%, ndërsa shkurti mbeti pothuajse në të njëjtat nivele me një vit më parë. Ritmi u përsheptua më pas, me rritje prej 10.8% në mars, 8.8% në prill dhe 15.9% në maj.

Në qershor, rritja ra sërisht në vetëm 1.3%, përpara përmirësimit të korrikut. Për tetë muajt e parë të vitit, hyrjet e shtetasve të huaj arritën në 9.44 milionë, nga 8.97 milionë në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rritja kumulative ishte 5.3%, pothuajse e njëjtë me ritmin prej 5.15% të regjistruar në tetë muajt e parë të vitit të kaluar.

Ecuria është në linjë me pritshmëritë e shprehura gjatë sezonit nga operatorët turistikë, të cilët kanë vlerësuar se viti 2026 mund të mbyllet me një ritëm të ngjashëm me vitin e kaluar.

Të dhënat e lëvizjes së shtetasve vijnë në një sezon që operatorët e konsiderojnë pozitiv për sa i përket numrit të vizitorëve, por me më shumë pikëpyetje për të ardhurat që po gjenerojnë këto flukse. Një zhvillim pozitiv është zgjatja e sezonit, i cili, sipas rezervimeve të deritanishme, pritet të vijojë deri në dhjetëditëshin e parë të tetorit.

Operatorët nënvizojnë se rritja e numrit të turistëve duhet parë veçmas nga të ardhurat që sjell sektori. Vetëm bilanci në fund të sezonit pritet të tregojë nëse numrat më të lartë të vizitorëve janë përthyer edhe në më shumë të ardhura. Ndryshime janë vënë re edhe në sjelljen e turistëve.

Të huajt këtë vit po qëndrojnë për periudha më të shkurtra, ndërsa është rritur përdorimi i apartamenteve dhe shtëpive private, si edhe i formulës "self-catering", ku turistët blejnë ushqimet dhe i përgatisin vetë.

Rezervimet e momentit të fundit dhe kujdesi më i madh me shpenzimet janë bërë gjithashtu më të dukshme në disa prej tregjeve kryesore europiane që sjellin vizitorë në Shqipëri.

Një sinjal pozitiv është rritja e kontratave me garanci për vitin e ardhshëm të cilat kanë ardhur si në volum edhe në të ardhura. Grupet që kanë vijuar të shfaqin interes për këtë janë polakët, çekët dhe francezët por nuk mungojnë as grupe të tjera.

“Gjatë muajit Gusht 2026, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 3.459.588 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 2,7 %, krahasuar me Gusht 2025. Gjithashtu, 3.571.685 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 7,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet në Shqipëri:

- Shtetas shqiptarë: 1.030.056 (ritje me 4,4 %)
- Shtetas të huaj: 2.429.532 (ritje me 2,0 %)

Daljet nga Shqipëria:

- Shtetas shqiptarë: 1.054.978 (ritje me 6,1 %)
- Shtetas të huaj: 2.516.707 (ritje me 7,5 %)”

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 25 Shtator11:24

[U ekstradua nga Italia, Gjykata e Posaçme lë në burg Hasan Ndërbakun](#)

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka vendosur të lërë në burg Hasan Ndërbakun, i cili u...

AKTUALITET 25 Shtator11:22

[Gazeta amerikane: Gjenerali Wendt zbarkon në Shqipëri në kohën kur vendi është përfshirë nga protestat](#)

Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Eric Wendt, pritet të mbërrijë së shpejti në ...

AKTUALITET 25 Shtator11:04

[Vodhi 700 mijë euro! Ish-drejtoresha e Postës Durrës i shpëton burgut](#)

Gjykata e Durrësit ka zbutur masën e sigurisë nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi” për i...

AKTUALITET 25 Shtator11:00

[Zgjedhja e tre anëtarëve të rinj të KLGJ, Sokol Sadushi: Kushtetuta nuk negociohet, siguria e gjyqtarëve nuk është çështje komoditeti](#)

Kryetari i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi, ka mbajtur fjalën e tij në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve t...

AKTUALITET 25 Shtator10:56

[Sapo ishte martuar, sëmundja i merr jetën 31-vjeçares shqiptare](#)

Pistoia është përfshirë nga dhimbja pas ndarjes së parakohshme nga jeta të Sara Memishës, 31-vjeçares me origjin&eum...

AKTUALITET 25 Shtator10:43

[Kapen duke shitur kokainë, dy të arrestuar në Lushnje](#)

Dy persona janë arrestuar nga Policia në Lushnje, pasi akuzohen për shitje të lëndëve narkotike. Sipas policisë, në p...

AKTUALITET 25 Shtator09:57

[Kishin ngritur një ‘mega-fabrikë’ droge në qytet, shkatërrohet rrjeti shqiptar në Spanjë](#)

Garda Civile spanjolle, në kuadër të operacionit “Bimban”, ka shkatërruar një laborator të brendshëm me 400 bim...

AKTUALITET 25 Shtator09:41

[Territorialja/ Intelektualët kundër shkrirjes së Bashkisë Patos, letër drejtuar Kuvendit: Të kryhet analizë para çdo vendimmarrjeje](#)

Intelektualë të njohur, përfshirë aktorë, avokatë e shkrimtarë i janë drejtuar Kuvendit me një letër lidhur me...

AKTUALITET 25 Shtator09:42

[Në kulmin e krizës, pritet të shtohet taksa e re për naftën 3 lekë/litër – Efekti përlllogaritet në 40 mln euro/vit](#)

Në kulmin e krizës së çmimeve, karburanteve pritet t’u shtohen edhe 40 mln euro të tjera në vit barra fiskale nga vendos...

AKTUALITET 25 Shtator09:10

[VIDEO/ Bledi Çuçi dhe bashkëshortja përplasen me protestuesit, gjeste të turpshme në mes të kafenesë](#)

Një situatë e paprecedentë është regjistruar mbrëmjen e kaluar në një kafene në Tiranë. Sipas pamjeve t&eum...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...](#)

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...](#)

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...](#)

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnamit ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)


Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**

“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.